



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

**Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës**  
**Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture**  
**Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure**

---

**Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës**

Në mbështetje të nenit 5,6,7 dhe 8 të Ligjin Nr. 05/L-064 për Patentë Shoferi ( Gazeta zyrtare Nr.17/10 Qershor 2016), ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin me Nr.06/L-066 dhe Ligjin Nr.08/L176, nenin 11 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, Nr.34/22 dt. 18.11.2022), nenin 4, paragrafi 1.10 dhe Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr.15/ 12 Shtator 2011),

Nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MMPHI) Nr. 16/2023 PËR LICENCIMIN E AUTO SHKOLLAVE**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kushtet dhe procedurat që duhet të plotësoj personi fizik apo juridik për ushtrimin e veprimtarisë së auto shkollës.

**Neni 2**  
**Fusha e zbatimi**

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen nga Ministria dhe personat tjerë fizik dhe juridik të përfshirë në procesin e aftësimit të kandidatëve për shofer.

**Neni 3**  
**Përkufizimet**

Shprehjet dhe termat e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë kuptim të njëjtë me përkufizimet e përcaktuara në Ligjin për Patentë Shoferi.

#### **Neni 4 Kushtet për licencim**

1. Për ushtrimin e veprimtarisë Auto shkolla duhet të ketë:

- 1.1. klasën mësimore;
- 1.2. zyrën administrative;
- 1.3. poligonin për aftësimin e kandidatëve nga pjesa praktike;
- 1.4. automjetet;
- 1.5. personelin e kualifikuar;
- 1.6. pajisjet mësimore dhe
- 1.7. njëjën sanitare.

#### **Neni 5 Klasa mësimore**

1. Klasa mësimore në të cilën zhvillohet aftësimi i kandidatëve për shofer nga pjesa teorike duhet të ketë:

- 1.1. sipërfaqe se paku 18m<sup>2</sup>;
- 1.2. 1.5m hapësirë pune për kandidatë;
- 1.3. 3m<sup>2</sup> hapësirë pune për ligjëruesin;
- 1.4. ndriçim dhe ngrohje;
- 1.5. aparatën për fikjen e zjarrit;
- 1.6. pajisjet mësimore:
  - 1.6.1. tavolinë për ligjëruesin profesional;
  - 1.6.2. tabelë shkollore ose pajisje tjetër që mundëson të shkruhet me përmasa minimale 1.0 x 0.8 m;
  - 1.6.3. tavolinë dhe ulëse për kandidat për shofer;
  - 1.6.4. projektor apo pajisje të ngjashme;
  - 1.6.5. së paku tre ( 3) kompjuter ose laptop apo te ngjashme;
  - 1.6.6. një (1) maket apo pano me:
    - 1.6.6.1. shenja vertikale, horizontale, dhe tabela plotësuese;

1.6.6.2. semafor, dhe shenjat që jep personi i autorizuar-polici;

1.6.6.3. aksidentet rrugore;

1.6.6.4. rrugën e reagimit- frenimit dhe ndaljes;

## **Neni 6** **Zyra administrative**

1. Auto shkolla duhet të ketë edhe zyrën për kryerjen e punëve administrative të ndarë me ndarje fizike me material te fortë nga klasa mësimore me hapësirë prej së paku 1,5 m<sup>2</sup> për person.

2. Zyra administrative duhet të ketë:

2.1. tavolinë dhe ulëse;

2.2. kompjuter apo laptop;

2.3. së paku dy (2) ulëse tjera për palë si dhe

2.4. sirtar për vendosjen e dokumentacionit.

3. Auto shkolla duhet te vendos ne selinë e saj emrin e auto shkollës, adresën dhe njoftimin për orarin e punës.

## **Neni 7** **Poligoni**

1. Poligoni i auto shkollës duhet jetë me asfalt, beton, kubëza, apo ndonjë material tjetër të ngjashëm dhe i shënuar me elementet teknike sipas Udhëzimit Administrativ për dhënien e provimit për patentë shoferi.

2. Një poligon mund ta shfrytëzojnë më së shumti pesë (5) auto shkolla.

3. Poligoni nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të jetë brenda territorit të komunës ku është selia e auto shkollës.

## **Neni 8** **Automjetet**

1. Auto shkolla duhet t'i aftësoj kandidatët për shofer me automjetet të cilat i plotësojnë kushtet te përcaktuara në Ligjin për Patentë Shoferi, Udhëzimin Administrativ për dhënien e provimit për patentë shofer dhe me këtë udhëzim administrativ.

2. Automjetet nga paragrafi 1 i këtij duhet t'i posedoj edhe pajisjet e me poshtme shtesë:

2.1 Për kategorinë B:

2.1.1. komandat e dyfishta të frenimit dhe friksionit;

2.1.2. dy (2) pasqyre nga ana e brendshme dhe e jashtme;

2.1.3. tetë (8) kona;

2.2. Për kategorinë C1:

2.2.1. komandat e dyfishta të frenimit dhe friksionit;

2.2.2. dy (2) pasqyre nga ana e jashtme;

2.2.3. katër (4) kona.

2.3. Për kategorinë C:

2.3.1. komandat e dyfishta të frenimit;

2.3.2. dy (2) pasqyre nga ana jashtme;

2.3.3. katër (4) kona.

2.4. Për kategorinë BE së paku dy (2) pasqyre varësisht nga konstruksioni i rimorkios;

2.5. për kategoritë “D1”, “D”, “C1+E”, “C+E”, “D1+E”, “D+E” së paku 2 (dy) pasqyre nga ana e jashtme e pjesës së përparme të automjetit;

2.6. për kategoritë: “C1”, “C”, “D1”, “D”, “C1+E”, “C+E”, “D1+E” dhe “D+E” ; të instaluar tahografin;

2.7. për kategoritë “C1”, “C”, “D1”, “D”, “C1+E”, “C+E”, “D1+E”, “D+E” aparatit për fikjen e zjarrit;

2.8. për kategorinë AM, A, A1, A2, A:

2.8.1. pajisjet komunikuese;

2.8.2. helmetën mbrojtëse;

2.8.3. jelekun me ngjyrë të kaltër, ndërsa shkronja “L” e shënuar me ngjyrë të bardhë reflektuese;

2.8.4. tetë (8) kona;

2.9. për kategorinë T pajisjet komunikuese;

3. Pajisjet shtesë nga nënparagrafi 2.1.1. dhe 2.3.1. i këtij nenit duhet të jenë të atestuar dhe verifikuara sipas legjislacionit në fuqi nga organi kompetent.

4. Aftësimi i kandidatëve për shofer të kategorisë “B” nuk mund bëhet me Automjet i cili posedon vetëm dy (2) ulëse.

5. Shënjzimi i automjetit sipas kategorive përkatëse bëhet sipas shtojcës I të këtij Udhëzimi Administrativ.

## **Neni 9**

### **Automjetet e kategorisë A**

1. Automjeti për aftësimin e kandidatëve për shofer nga pjesa praktike duhet të ketë për kategorinë:
  - 1.1. AM - Mopedin me vëllim punues deri 50 cm<sup>3</sup>;
  - 1.2. A1 - Motoçikletën me vëllim punues së paku 120 deri 399 cm<sup>3</sup>;
  - 1.3. A2 - Motoçikletën pa rimorkio anësore me vëllim punues prej 400 cm<sup>3</sup> -599 cm<sup>3</sup> ;
  - 1.4. A - Motoçikleta pa kufizime – me vëllim punues prej së paku 600 cm<sup>3</sup>.

## **Neni 10**

### **Personeli i auto shkollës**

1. Auto shkolla duhet të ketë të punësuar me kontratë pune:
  - 1.1. Udhëheqësin profesional i cili duhet t'i plotësoj kushtet e përcaktuar në nenin 9 të Ligjit Nr.05/L-064 për patentë shoferi;
  - 1.2. Së paku një ligjërues profesional të licencuar;
  - 1.3. Së paku dy instruktor shoferë të licencuar për kategorinë “B” dhe së paku një (1) për secilën kategori që licencohet.

## **Neni 11**

### **Dokumentacioni për aplikim**

1. Aplikacionit për licencim të auto shkollës i bashkëngjiten këto dokumente:
  - 1.1. dëshmia për regjistrimin e biznesit të lëshuar nga organi kompetent;
  - 1.2. dëshmia mbi pronësinë apo marrjen me qira të hapësirave punuese në origjinale ose kopje e noterizuar;
  - 1.3. skica e zyrës, klasës mësimore dhe poligonit;
  - 1.4. lista e personelit:
    - 1.4.1. kontratën, diplomën apo certifikatën e përgatitjes shkollore, letërnjoftimin, patentë shoferin, certifikatën nën hetime të lëshuar nga gjykata (kopje) të udhëheqësit profesional në auto shkollë;
    - 1.4.2. kontratën, letërnjoftimin, patentë shoferin dhe licencën vlefshme (kopje) të ligjëruesit profesional;
    - 1.4.3. kontratën, letërnjoftimin, patentë shoferin dhe licencën e vlefshme (kopje) të instruktor shoferit;
  - 1.5. listën e automjeteve:

- 1.5.1. certifikatën e regjistrimit të automjetit (kopje);
- 1.5.2. certifikatën e kontrollimit teknik periodik;
- 1.5.3. fotot e automjeteve;
- 1.5.4. “Certifikatën e Atestit” të komandave të dyfishta” për kategorinë B (kopje);
- 1.5.5. “Certifikatën e Atestit” për komanda të dyfishta ” për kategoritë: “C1”, ”C”, ”D1”, ”D”, ”C1+E”, ”C+E”, ”D1+E” dhe “D+E” e cila duhet të përmbaj edhe këto të dhëna:
  - 1.5.5.1. dimensionet;
  - 1.5.5.2. sistemin e ABS;
  - 1.5.6.3. masa dhe
  - 1.5.6.4. tahografin.

2. Dokumentacioni i kompletuar nga paragrafi 1 i këtij neni dorëzohet në arkivin e Ministrisë për Departamentin e Automjeteve - Divizionin e Auto shkollave, apo në mënyrë elektronike pas funksionalizimit të sistemit elektronik.

## **Neni 12**

### **Komisioni për shqyrtimin e kërkesës**

1. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë me vendim emëron komisionin për shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave të subjekteve për licencim, përtëritje licencës dhe ndërrim të kushteve hapësinore të auto shkollës.
2. Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni:
  - 2.1. shqyrton kërkesën, dokumentacionin dhe bënë verifikimin e kushteve për licencim, përtëritje licencës dhe ndërrim të kushteve hapësinore.
  - 2.2. harton procesverbal gjatë verifikimit të kushteve;
  - 2.3. merr vendim për pranimit apo refuzim kërkesës.
3. Shqyrtimi i kërkesave nga komision bëhet në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

## **Neni 13**

### **Lëshimi i licencës**

1. Licencën e auto shkollës e lëshon Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë.
2. Licenca vlen pesë vite (5) nga data e lëshimit të vendimit.

## **Neni 14 Tarifat**

1. Auto shkolla duhet të paguaj:

1.1.për marrjen e licencës apo për përtëritjen e licencës për secilën kategori 180 €;

1.2. për ndërrim te hapësirave punuese 50 €;

1.3. për zëvendësimin e licencës 10 € .

2. Shuma e përcaktuar nga paragrafi 1.2 të këtij neni Auto shkolla e paguan me rastin e aplikimit.

## **Neni 15 Ndërrimi i kushteve**

1. Auto shkolla për ndërrim të hapësirave punuese: selisë, klasës mësimore apo poligonit paraqet kërkesë me shkrim në Arkivin e Ministrisë të cilës i bashkëngjit dokumentacionin përkatës.

2. Komisioni nga neni 12 i këtij Udhëzimit Administrativ bënë verifikimin e kushteve: klasës mësimore, zyrës apo poligonit dhe harton procesverbal lidhur me te gjeturat në vendndodhje.

3. Për ndryshimin e personelit dhe automjeteve, Auto shkolla përmes e-mailit zyrtar njofton dhe e dorëzon dokumentacionin - dosjen e skanuar, sipas nën paragrafit 1.4 te neni 11 të këtij udhëzimi administrativ në formë elektronike apo fizike në Departamentin e Automjeteve /Divizionin e auto shkollave dhe në Departamentin e Inspektoratit.

## **Neni 16 Zëvendësimi i licencës**

1. Zëvendësimi i licencës behet me kërkesë të auto shkollës kur deklarohet e humbur, e dëmtuar, në të janë bërë të palxueshme të dhënat apo për shkak të ndërrimit të dhënave apo ngjashme.

## **Neni 17 Përtëritja e licencës**

1. Auto shkolla mund të paraqet kërkesë për përtëritjen e licencës 60 ditë para skadimit të afatit.

2. Për përtëritje të licencës Auto shkolla duhet t'i plotësojë kushtet e parapara si me rastin e licencimit.

## **Neni 18**

### **Procedura për pezullim të licencës**

1. Auto shkollës i pezullohet licenca për të gjitha kategoritë në rastet vijuese:
  - 1.1. me vendim të gjykatës;
  - 1.2. klasa mësimore, zyra administrative dhe poligoni nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara;
2. Auto shkollës i pezullohet licenca për kategorinë përkatëse në rastet vijuese:
  - 2.1. bënë aftësim të kandidatëve në kundërshtim me plan programin për aftësim të kandidatit për kategorinë përkatëse;
  - 2.2. nuk ka së paku dy instruktorë të shoferëve për kategorinë B, ndërsa një instruktor të shoferëve për secilën kategori për të cilën licencohet, siç parashihet në nenin 6 të këtij ligji;
  - 2.3. bënë aftësim të kandidatëve me automjete pa i plotësuar kushtet sipas neneve 49 dhe 63 të këtij ligji dhe akteve nënligjore që nxirren në bazë të këtij ligji;
  - 2.4. nuk ka së paku dy automjete për kategorinë B, kurse një automjet për secilën kategori për të cilën licencohet, siç parashihet në nenin 6 të këtij ligji;
3. Vendimi për pezullimin e licencës merret nga personat e autorizuar nga Ministria respektivisht inspektorët e auto shkollave.
4. Pezullimi i licencës nuk mund të jetë në kohëzgjatje më të shkurtër se tridhjetë (30) ditë as më të gjatë se një qind e tetëdhjetë (180) ditë.

## **Neni 19**

### **Procedura për revokim të licencës**

1. Licenca i revokohet auto shkollës në këto raste:
  - 1.1. bënë aftësimin e kandidatëve nga pjesa teorike ose praktike gjatë kohës së pezullimit të licencës;
  - 1.2. kërkohet nga pronari i saj;
  - 1.3. vërtetohet se ka paraqit dokumentacion të pasaktë ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen ose përtëritjen e licencës;
  - 1.4. me vendim të plotfuqishëm të gjykatës i ndalohet ushtrimi i veprimtarisë për aftësimin e kandidatëve për shoferë.
2. Zyrtari i autorizuar respektivisht Inspektori i auto shkollës i propozon Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë të bëjë revokimin e licencës së auto shkollës sipas nënparagrafit 1.1 dhe 1.3 të këtij neni.
3. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë vendos lidhur me propozimin nga paragrafi 2 të këtij neni.



**Neni 20**  
**Mbyllja e veprimtarisë së auto shkollës**

1. Nëse Auto shkollës i revokohet licenca, përkatësisht e mbyll veprimtarin me kërkesën e tij, e njëjta mund të transferoj kandidatët për shofer në auto shkollën tjetër të licencuar brenda regjionit ku ka selinë,
2. Për transferimin e kandidatëve nga paragrafi 1 i këtij nenit auto shkolla përpilon raport me shkrim dhe i dorëzon këto dokumente:
  - 2.1. librin e evidencës për aftësimin e kandidatëve për shoferë (kopje),
  - 2.2. ditarin për mbajtjen e orëve mësimore nga pjesa teorike,
  - 2.3. dosjen e kandidatit dhe
  - 2.4. listën e kandidatëve të cilët nuk e kanë përfunduar aftësimin.
3. Auto shkolla kërkesën për mbylljen e veprimtarisë e parashtron në Ministri në Departamentin e Inspektoratit.
4. Auto shkolla nga paragrafi 1 i këtij nenit librin e evidencës për aftësimin e kandidatëve për shoferë të mbyllur nga Inspektori duhet të dorëzoj në NJPSH përkatëse.

**Neni 21**  
**Ndërrimi i pronarit të auto shkollës**

1. Auto shkolla për ndërrimin e pronarit, apo emrit duhet të dorëzoj këto dokumente:
  - 1.1. dëshmin me shkrim nga organi kompetent që është vazhdim i veprimtarisë;
  - 1.2. dosjen e auto shkollës: kontratat e punëtorëve dhe dëshminë e hapësirave punues;
2. Dokumentacionin nga paragrafi 1 i këtij nenit Auto shkolla e dorëzon në arkivin e Ministrisë në Departamentin e Automjeteve-Divizionin e auto shkollës.
3. Verifikimin e dokumentacionit nga paragrafi 2 i këtij nenit e bënë Departamenti i Automjeteve – Divizioni i auto shkollave dhe përpilon procesverbal.

**Neni 22**  
**Mbikëqyrja e punës së auto shkollës**

1. Mbikëqyrja e punës së auto shkollës bëhet nga zyrtarët e autorizuar të Departamenti të Inspektoratit në Ministri sipas legjislacionin në fuqi.

### **Neni 23**

#### **Kufizimet**

1. Auto shkollës së licencuar nuk i lejohet hapja e njësive, përfaqësisë, zyrave në vend tjetër.
2. Pronari i cili e mbyll auto shkollën nuk i lejohet hapja e auto shkollës së re brenda 12 muaj.

### **Neni 24**

#### **Dokumentacioni dhe evidenca**

1. Divizioni i auto shkollave mbanë në mënyrë fizike apo elektronike:
  - 1.1. kopjen e licencave;
  - 1.2. librin e evidencës të auto shkollave të licencuar;
  - 1.3. dokumentacionin e aplikimit (dosja e auto shkollës);
  - 1.4. procesverbalet.
2. Libri i evidencës së auto shkollave ruhet përherë – ndërsa dokumentacioni tjetër ruhen vetëm 5 vite gjatë kohës së vlefshmërisë së licencës.

### **Neni 25**

#### **E drejta e Ankesës**

1. Kundër vendimit për lëshim , pezullim dhe revokim të licencës , ndërrim të kushteve, pala e pakënaqur mund të parashtojë ankesë në Ministri në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
2. Ankesa shqyrtohet dhe vendoset nga komisioni i emëruar me vendim të Ministrit.

### **Neni 26**

#### **Shfuqizimi**

Me këtë Udhëzim Administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ (MI) nr.20/2017 për Licencimin e Auto Shkollave dhe Udhëzimi Administrativ (MI) Nr.05/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MI) Nr. 20/2017 për Licencimin e Auto Shkollave.

### **Neni 27**

#### **Dispozitat kalimtare**

Nën paragrafi 1.5.5 i nenit 11 zbatohet për automjetet të cilat e bëjnë atestimin nga data e hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimit Administrativ.

**Neni 28**  
**Shtojca**

1. Shtojca e këtij Udhëzimit Administrativ është pjesë përbërëse e saj:
  - 1.1.Shtojca I: Shënjzimi i automjetit sipas kategorive përkatëse.
  - 1.2.Shtojca II: Forma dhe përmbajtja e Licencës së auto shkollës.

**Neni 29**  
**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës Kosovës.

**Liburn ALIU**

---

Ministër i Ministrisë Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Datë: 12.10.2023.

## SHTOJCA I:

### **Forma, dimensionet dhe përmbajtja e shënjizimit të automjetit**

1. Tabela ndriçuese për kategorinë B duhet të jetë me ngjyrë të bardhë me mbishkrim “auto shkolla”. Në tabelë shënohet emri i auto shkollës, kurse shkronja L vendoset në anën e majtë të saj.
  
2. “L” pllaka – baza duhet të jetë me ngjyrë të kaltër dhe shkronja me ngjyrë të bardhë me materie reflektuese.
  - 2.1. “L- pllaka duhet të vendoset në automjet të:
    - 2.1.1. kategorisë “AM”, “A1”, dhe “A”, prapa nën apo mbi targat e regjistrimit;
    - 2.1.2. kategorisë “B1”, “B”, “B+E”, “T”, “C1”, “C1+E”, “C”, “C+E”, “D1”, “D1+E”, “D”, dhe “D+E”, në pjesën e përparme dhe pasme, në anën e majtë.
  
3. “L” pllaka vendoset vetëm gjatë aftësimit të kandidatëve nga pjesa praktike.
  
4. Tiketa ngjitëse vendoset në pjesën e djathtë dhe të majtë në dyert e automjetit të auto shkollës.

SHTOJCA I, ANNEX I, PRILOG I




Fig.1 Tabela ndriçuese për automjete / Lighting board for vehicles / Rasvjetna tabla za vozila




Fig.2. Pllakëza për kategoritë/ Tiles for categories / Pločice za kategorije:

“AM”, “A1”, “A2”, “A”, B1, B, BE,




Fig.3 “L” pllaka për kategoritë/ Tiles for categories/ Pločice za kategorije:

C1, C1E, C, CE, D1, D1E, D dhe DE



Fig. 4. Tiketa ngjitëse- Emërtimi i auto shkollës/ Stickers /The name of the driving school/ Nalepnica - Naziv auto-škole

SHTOJCA II, ANNEX II, PRILOG II: Forma dhe përmbajtja e licencës së Auto shkollës / Form and content of the Auto school license / Oblik i sadržaj licence Auto škole



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministartvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure*

Lëshon këtë / Izdaje se / Issues this

## LICENCË / LICENCA / LICENSE

Nr./Br./No.

Auto shkolla / Auto Skolla / Driving school

Nr. i biznesit / Br. Biznisa / Business No.

Komuna / Opština / Municipality

I plotëson të gjitha kushtet e parapara për licencim të kategorisë  
Ispunjava sve predviđene uslove za licenciranje kategorije  
Fulfills all conditions foreseen for licensing of category

Licenca vlen deri me dt./Licenca važi do/License is valid up to dt.

Me datën:

Datum:  
Date:

Sekretar i Përgjithshëm  
Generalni Sekretar  
Secretary General

---